

Njoftim

Sot, më datë **01.09.2023, ora 09:00**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Marsela Dervishi (Relatore);**
- 2. Sokol Ibi (Anëtar);**
- 3. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 4. Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 5. Edlira Petri (Anëtare);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr. "Ismail Qemali", Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen Nr.37 Regj.Themeltar, Datë 29.08.2023 Regjistrimi, me:

Paditës: Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Indrit Sefa.

I paditur: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve – KQZ, përfaqësuar nga znj. Ina Osmanaj dhe z. Erion Meta.

Person i interesuar: Partia e Lirisë, përfaqësuar nga z. Altin Kaziaj.

Objekti: Shfuqizimi i vendimit nr. 179, datë 22.08.2023, të KAS "Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 93, datë 20.08.2023, të depozituar nga "Partia Demokratike e Shqipërisë".

Detyrimin e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) të marrë vendim, lidhur me kërkesën ankimore nr. 93, Dt. 20.08.2023, depozituar nga subjekti "Partia Demokratike e Shqipërisë".

Baza ligjore: Nenet 21, 64, 65 dhe 66, 124, 124/1, 145 e në vazhdim të Kodit Zgjedhor; Nenet 1 dhe 2 të Udhëzimit nr. 01, datë 23.12.2020 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "*Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit*".

Për dijeni, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, me Vendim nr.179, datë 22.08.2023, objekt i kërkesëpadisë së mësipërme, ka vendosur:

"Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 93, datë 20.08.2023, të paraqitur nga "Partia Demokratike e Shqipërisë".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor”.

me Vendimin Nr. 34, datë 01.09.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e padisë.
2. Shfuqizimin e Vendimit Nr.179, datë 22.08.2023, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve “Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore Nr.93, datë 20.08.2023, të depozituar nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”.
3. Detyrimin e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve të marrë vendim përfundimtar në lidhje me kërkesën ankimore Nr.93, datë 20.08.2023, të depozituar nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”, brenda 2 ditëve nga njoftimi i vendimit të arsyetuar.
4. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.
5. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
6. U shpall në Tiranë më datë 01.09.2023.

Tiranë, më 01.09.2023

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë